



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ZGJEDHJE PARLAMENTARE
25 PRILL 2021

RAPORT MONITORIMI

ZBATIMI I LEGJISLACIONIT MBI DEKRIMINALIZIMIN NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE



bashkëpunimi
gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Ky raport tematik është përgatitur në kuadër të projektit “Drejt integritetit më të mirë të kandidatëve, për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme në 5 Bashki të vendit”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga Republika Federale Gjermane.

RAPORT MONITORIMI
ZBATIMI I LEGJISLACIONIT MBI DEKRIMINALIZIMIN NË ZGJEDHJET
PARLAMENTARE
25 PRILL 2021

Tiranë, Qershor 2021



Ky raport tematik është përgatitur në kuadër të projektit “Drejt integritetit më të mirë të kandidatëve, për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme në 5 Bashki të vendit”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga Republika Federale Gjermane.



Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Republikës Federale Gjermane.

Përgatiti:

1. Znj. Ardita Kolmarku, Juriste/Koordinatore Projektesh, KShH
2. Znj. Servete Çeka, Juriste/Asistente Projektesh, KShH

Supervizuan dhe rishikuan raportin:

1. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor i KShH-së
2. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e KShH-së

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor:

©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”

Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Cel: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

Lidhur me procesin e dekriminalizimit, legjislacioni¹ në Republikën e Shqipërisë synon krijimin e mekanizmave ndalues për zgjedhjen e shtetasve të cilët ndodhen në rrethana që çenojnë integritetin e funksionarit publik. Në realizimin e këtij procesi verifikues janë të përfshirë institucione të rëndësishme si Prokuroria e Përgjithshme, KQZ, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe autoritetet homologe të vendeve fqinje.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Prokuroria e Përgjithshme, KShH vëren në tërësi, se partitë politike nuk kanë interes për të verifikuar paraprakisht kandidatët e listave të tyre shumëëmërore, duke mos kontribuar në drejtim të zbatimit efektiv të legjislacionit të dekriminalizimit. Nga monitorimi i formularëve të vetëdeklarimit të 584 kandidatëve të propozuar nga subjektet politike të regjistruara dhe kandidatë të pavarur, në 5 Qarqet të vendit, indiciet që kanë nxitur KQZ-në për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme kanë qenë të dhënat e dokumentuara nga vetë subjektet në formularët e tyre të dekriminalizimit. Vetëm në 1 rast, për një kandidat të pavarur, KQZ ka kërkuar verifikim bazuar në indiciet e vendimmarrjeve të saj të mëparshme për mosrespektim të kuotave gjinore nga ana e këtij kandidati. Gjatë periudhës së monitorimit të këtij procesi rezulton se vetëm në rastin e 1 kandidati pjesë e listës së 5 qarqeve objekt monitorimi, është përfunduar procesi i verifikimit nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, duke mos gjetur cënim të legjislacionit për dekriminalizimin. Ndaj 9 kandidatëve, pjesë e listave shumëëmërore të subjekteve në qarqet objekt monitorimi, rezulton se Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar informacion nga ana e autoriteteve policore të huaja apo Ministrive të Drejtësisë homologe.

1 Kuadri ligjor dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Në përputhje me nenet 6/1 dhe 45 të Kushtetutës dhe dispozitave të përcaktuara në ligjin nr. 138/2015 dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nën përcaktim të procedurave dhe kriterëve ligjorë janë përjashtuar nga e drejta kushtetuese për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur shtetasit e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Kjo tematikë ka qenë objekt monitorimi vetëm në 5 Bashkitë e vendit. Kandidatët pjesë e listave shumë emërore të subjekteve zgjedhore të regjistruara kanë depozituar formularët e vetë-deklarimit, në respektim të pikës 9 të kreut II të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit.

Nëpërmjet vendimmarrjes së datës 11/12/2020, Komisioni Rregullator ka vendosur miratimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore. Nga njoftimi publik i KQZ-së, rezulton se 12 subjekte zgjedhore të regjistruara kanë respektuar afatin, dt. 08.03.2021, për përcjelljen e dokumentacionit të kandidimit.²

KShH ka shkëmbyer korrespondenca zyrtare me Prokurorinë e Përgjithshme³ dhe KQZ për të

¹ Ligjet nr. 137/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të miratuara në vitin 2015

² <http://kqz.gov.al/2021/03/09/kqz-verifikimi-i-formulareve-te-vetedeklarimit-ne-bashkepunim-me-dpgjc-dhe-drejtorene-e-pergjithshme-te-burgjeve/>

³ Shkresë nr. 688/1 prot., dt. 29.04.2021

mbikqyrur zbatimin e ligjit të dekriminalizimit.⁴ Me keqardhje konstatojmë se sipas të dhënave të përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton se vetëm subjekti politik PD-AN ka depozituar një kërkesë për kryerjen e verifikimit paraprak për kandidatin për deputet të këtij subjekti zgjedhor. Për shkak të mosplotësimit të të metave/pasaktësive të kërkesës, kjo kërkesë nuk është pranuar nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme. Bazuar në këto të dhëna, KShH vëren se partitë politike nuk kanë interes për të verifikuar paraprakisht kandidatët e listave të tyre shumëëmërore, duke mos kontribuar në drejtim të zbatimit efektiv të legjislationit të dekriminalizimit.

Nga të dhënat e përcjella nga ana e këtyre institucioneve, rezulton se brenda një afati 3 ditor, nga dt. 22.03.2021 deri më dt. 25.03.2021, KQZ ka kërkuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme kryerjen e verifikimit të plotë, për 30 kandidatë për deputetë në Zgjedhjet Parlamentare të 25 Prillit 2021. Nga këto, për 4 kandidatë, kërkesa për ndërmarrjen e procedurave verifikuese është bazuar në indiciet e konstatuara nga KQZ gjatë verifikimit të formularëve të vetë-deklarimit që vetë kandidatët kanë plotësuar. Prokuroria e Përgjithshme, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 138/2015, ka realizuar procedurën e verifikimit për 4 subjekte vetë-deklaruese, brenda afatit 30 ditë kalendarike. Për këto 4 subjekte është konstatuar se është ndërmarrë vendimi për miratimin e rezultateve verifikuese, ndërkohë që asnjërit prej subjekteve nuk rezulton t'i jetë pezulluar e drejta për t'u zgjedhur.

Për 26 persona ose 87%, Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit i ka kërkuar informacion autoriteteve policore të huaja (Interpol/Europol). Interpol ka ofruar informacion vetëm për 11 subjekte, ndërkohë që vijon procedura e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë e cila realizohet nga Ministria e Drejtësisë. Deri në këto momente, Prokuroria e Përgjithshme në vendin tonë nuk ka marrë asnjë informacion konkret sa i takon verifikimeve të kryera. Disa nga vështirësitë që referohen gjatë fazës së marrëdhënies juridiksionale me jashtë janë: mos ofrimi i informacionit nga Interpol dhe Europol për shkak se kërkesa e adresuar nuk plotëson kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH, si dhe mospërfundimi i procesit të verifikimit brenda afateve ligjore (në disa raste ka zgjatur me vite) për shkak të kërkesave adresuar autoriteteve gjyqësore të huaja, të cilave nuk iu ka mjaftuar si bazë ligjore ligji nr. 138/2015; “Protokolli i dytë shtesë i Konventës së KE për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale” dhe Konventa “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale”. Në këtë situatë, ligji për dekriminalizimin nuk garanton kontrollin e plotë dhe të saktë të integritetit të kandidatëve që garojnë në Zgjedhjet (Parlamentare ose të Qeverisjes vendore), duke krijuar situata kur një kandidat, i/e cili/a mund të marrë mandatin e të zgjedhurit, më pas të rezultojë me pengesa për shkak të përgjigjeve të sjella më vonë nga autoritetet e huaja apo edhe në rastin më të keq, mund të ketë mungesë përgjigjeje për ta.

Gjithashtu, një tjetër shqetësim i ngritur nga Prokuroria e Përgjithshme lidhet me mos informimin nga ana e organeve përgjegjëse që administrojnë formularin e vetëdeklarimit, lidhur me personat që iu rezultojnë ose jo në kushtet e ndalimit, pasi përfundon procesi i verifikimit të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

2 Të dhënat e verifikuara manualisht nga formularët e vetë-deklarimit të kandidatëve

Ekspertët e KShH-së konstatuan se KQZ, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi ka

⁴ Shkresë nr. 4545/1 prot., dt. 17.05.2021


pasqyruar në faqen e saj zyrtare, formularët e vetë-deklarimit të kandidatëve për deputet. Nga verifikimi manual i formularëve të kandidatëve të subjekteve më të mëdha politike (PS, LSI dhe koalicioni PD-AN), për 5 Qarqet e vendit, pjesë e të cilave janë Bashkitë objekt monitorimi rezultoi se:

- a) **Për Qarkun Shkodër** (pjesë e të cilit është Bashkia Malësi e Madhe) – pjesa më e madhe e kandidatëve subjekte plotësuese dhe nënshkruese të formularëve të vetë-deklarimit kanë reflektuar në to vendimmarrjet e dëbimit nga shtetet fqinje, ose masat të sigurimit penal, të ndërmarra nga ana e autoriteteve proceduese vendase. KShH ka konstatuar se në raste sporadike, kandidatët nuk kanë referuar publikisht veprën penale të cilën dyshohet se kanë kryer. P.sh: kandidati F.GJ. ka deklaruar se ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal ‘arrest në shtëpi’ për ngjarjet e 14 shtatorit 1998. Në vitin 2002, rezultoi që sistemi gjyqësor të ketë disponuar me vendimmarrje pafajësie ndaj kandidatit, por në formularin e vetë-deklarimit nuk rezultoi datë dhe numër identifikues i kësaj vendimmarrje të gjykatës, dhe as vepra penale e cila dyshohet të jetë kryer prej këtij shtetasi. Për 3 kandidatë të tjerë rezultoi se Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar informacion nga ana e KQZ dhe autoriteteve proceduese, bazuar në indicie paraprake. Në listën shumëemërore të kandidatëve për subjektin LSI, vetëm kandidati A.T. rezultoi të ketë deklaruar dëbimin nga shteti fqinj italian në vitin 2007, për 5 vite. Nga një verifikim i listës së kandidatëve për Qarkun Shkodër rezultoi se vetëm kandidati B.S. (subjekti politik PD-AN) ka qenë subjekt i masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi” dhënë nëpërmjet vendimit dt. 09.11.2020, i cili është revokuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Procedimi penal në ngarkim të tij rezultoi të jetë regjistruar për veprat penale të parashikuara në nenet 242 “Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik” dhe 235/2 “Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik” të Kodit Penal, jo pjesë e kritereve ndaluese të parashikuara në nenin 2 të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave nga lista e 12 kandidatëve të subjektit zgjedhor PS për Bashkinë Shkodër rezultoi se vetëm kandidati F.Gj. ka deklaruar caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” për ngjarjet e 14 Shtatorit 1998. Në vitin 2002, kandidati është deklaruar i pafajshëm, por në formular nuk konstatohet referim i veprës penale për të cilën dyshohet se ka kryer si dhe të dhëna identifikuese të vendimmarrjes. Nga të dhënat e bëra publike dhe të vërtetuara nëpërmjet korrespondencave zyrtare me institucionet, rezultoi se kandidatët A.Gj. (subjekti ABEOK), i cili është dëbuar nga shteti gjerman në vitin 2017; B.Sh. (subjekti BD), i dënuar me burgim rreth 1 muaj në Mars 1998 për emigrim të paligjshëm dhe Z.H. (subjekti PD) i cili nuk ka referuar të dhëna në formularin e vetëdeklarimit. Gjithashtu, dhe për kandidatin S.H. (subjekti PSD), më dt. 16.04.2021 rezultoi se Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka kërkuar informacion shtesë nga ana e KQZ.⁵ Kandidati T.D. i cili rezultoi në listën shumë emërore të subjektit PSD për qarqet Shkodër dhe Tiranë, në formularin e vetë deklarimit ka referuar se në vitin 1990 është dënuar me 1 vit heqje lirie për veprën penale 121 dhe 31/a të K.Penal. Ndërkohë në vitin 2015 ndaj tij rezultoi të jetë caktuar masë e sigurimit “arrest në shtëpi” si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 305, 305/a dhe 312

⁵ <https://shqiptarja.com/lajm/prokuroria-perfundon-verifikimin-per-kandidatin-per-deputet-napolon-lasken-nuk-rezulton-i-denuar-per-kryerjen-e-ndonje-vepre-penale?r=pop5s> ⁶ <https://shqiptarja.com/lajm/kreu-i-dekriminalizimit-stojani-per-report-tv-per-tom-doshin-kemi-kerkuar-informacion-nga-shba-do-ti-kerkojme-kandidateve-per-deputete-gjurmimet-e-gishterinjve?r=dtr>

K.Penal. Kjo masë sigurimi e ndryshuar rreth 1 muaj më vonë me atë të detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore u shua në vitin 2018, nëpërmjet vendimit përfundimtar të pafajësisë. Për këtë kandidat konstatohet se Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar informacion shtesë nga Ambasada e SHBA-ve dhe nga vende të tjera fqinje në të cilat kandidati ka qëndruar më parë.⁶ Ndaj kandidatit të pavarur për qarkun Shkodër P.Sh. është depozituar kërkesë për verifikim edhe pse asnjë e dhënë në cënim të integritetit nuk është reflektuar nga ana e subjektit në formularin e vetëdeklarimit.⁷

- b) Për **Qarkun Lezhë** (pjesë e të cilit është Bashkia Lezhë), konstatohet 1 rast që kandidati për deputet S.K. ka referuar se ndaj tij është caktuar masë sigurimi personal “detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”, e cila rezulton të jetë revokuar më pas. Por në



formularin e vetëdeklarimit nuk ofrohen të dhëna provuese mbi këtë referim. Pavarësisht se kjo vendimmarrje nuk është e formës së prerë, vlerësojmë se në kuadër të transparencës, KQZ duhet të kërkonte informacion të detajuar nga organet proceduese mbi këtë vendimmarrje. Parë në raport krahasimor me Qarkun Shkodër vërehet se KQZ ka kërkuar verifikim të përgjithshëm nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme për subjektet të cilët kanë vetë-deklaruar në formularët e tyre situata

dëbimi nga shtetet fqinje, por jo të gjithë kandidatët kanë dokumentuar shkaqet e dëbimit. **Në këtë kontekst, KShH vlerëson se qasja e KShH-së duhet të jetë e unifikuar.**

Për qarkun Lezhë, u verifikuan elektronikisht nga ekspertët e KShH-së formularët e dekriminalizimit të publikuar të 108 kandidatëve të propozuar nga 12 subjektet elektorale të regjistruara në formën e partive (9 kandidatë secili) dhe nga 1 subjekt i pavarur. Nga verifikimi i kandidatëve të propozuar nga subjekti zgjedhor PS, rezulton se asnjë prej tyre nuk ka dokumentuar se ndodhet në kushtet ndaluese për të kandiduar në Zgjedhjet Parlamentare Prill 2021. Për subjektin zgjedhor LSI, kandidati D.N. ka referuar se është dënuar me dënim alternativ sipas nenit 63 K.Penal, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive,

interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” parashikuar nga neni 257/a/2 K.Penal. Kandidati nuk rezulton të jetë dënuar me vendim të formës së prerë pasi çështja në ngarkim të tij është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit, ndërkohë që kjo vepër penale nuk është e parashikuar në spektrin e ndalimeve për të kandiduar të ligjit nr. 138/2015. Pas njohjes me formularin e vetëdeklarimit të kandidatit të partisë PD, S.Kaçaj,

5. A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo? (Vendos X përballë përgjigjes)

PO ☒ JO ☐

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Sotemir K...
(emër, mbiemër, shkronja)

PERGJIGJE	Aktualisht në fuqi	E revokuar
Ndërimi i dajës jashtë shtetit	☐	☐
Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore	☐	☒
Ndërimi ose detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar	☐	☐
Garancia pasurisë	☐	☐
Arrest në shtëpi	☐	☐
Arrest në burg	☐	☐
Shtrimi i personit në një spital psikiatrik	☐	☐


- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

⁶ <https://shqiptarja.com/lajm/kreu-i-dekriminalizimit-stojani-per-report-tv-per-tom-doshin-kemi-kerkuar-informacion-nga-shba-do-ti-kerkojme-kandidateve-per-deputete-gjurmte-e-gjshterinje?r=dtr>

⁷ <https://abcneës.al/pas-kerkeses-se-kqz-se-njesia-e-dekriminalizimit-nis-verifikimin-per-bojken-abazin-e-pal-shkambin/> ⁸ <https://ëëë.zeriamerikes.com/a/xhelal-mziu-arrest/1814639.html>

konstatohet se ai ka referuar se ndaj tij është caktuar masë sigurimi personal “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, e cila rezulton të jetë revokuar më pas. Por në formularin e vetëdeklarimit nuk ofrohen detaje provuese mbi këtë referim. Pavarësisht se kjo vendimmarrje nuk është e formës së prerë, vlerësojmë se në kuadër të transparencës, KQZ duhet të kërkonte informacion të detajuar nga organet proceduese mbi këtë vendimmarrje. Për Qarkun Lezhë, rezulton se është kërkuar verifikim për kandidatin I.K. (subjekti LRE), i cili është dëbuar në vitin 2018 nga Greqia për mungesë dokumentacioni.


- c) Nga monitorimi i kandidatëve pjesë e listave shumëemërore të depozituara nga subjektet politike për **Qarkun Dibër**, rezulton se vetëm 2 kandidatë kanë dokumentuar në formularët e tyre të vetë-deklarimit masat penale të dhëna ndaj tyre. Veprat penale të cilat dyshohen se mund të jenë kryer prej këtyre shtetasve nuk përfshihen në fushë veprimin e ligjit nr. 138/2015. Në proporcion me ndarjen e mandateve nga ana e KQZ-së për **Qarkun Dibër**, u verifikuan formularët e dekriminalizimit të 69 kandidatëve të propozuar nga 12 subjektet elektorale të regjistruara në formën e partive (6 kandidatë secili) dhe nga 1 subjekt i pavarur.



Për subjektin zgjedhor PD, kandidatët në **Qarkun Dibër**, Xh.M. dhe L.H. rezultojnë të dy të ndaluar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale.

Ndërkohë ndaj shtetasit L.H. rezulton se nuk është regjistruar asnjë procedim penal në ngarkim të tij për kundërshtim të punonjësit të Policisë, por ky shtetas rezulton që fillimisht është shpallur në kërkim nga ana e forcave të rendit, për organizimin e protestës së Opozitës. Urdhëri i kërkimit lëshuar ndaj këtij shtetasi është revokuar më pas nga vetë Policia e Shtetit. Kandidati Xh.M. është proceduar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë me akuzën e shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim. Ndaj tij është vënë masa e arrestit me burg dhe pas apelimit të çështjes, Gjykata e Apelit e shpalli të pafajshëm.⁸


- d) Lidhur me **Qarkun Korçë**, konstatohet se vetëm 1 kandidat ka pasqyruar në formularin e tij të vetë-deklarimit, se ndaj tij policia ka kryer shoqërimin për pjesëmarrje në protesta/tubime të paligjshme. Ndaj këtij kandidati rezulton të jetë disponuar një masë administrative, por ky element nuk rezulton i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit.



Nga monitorimi i 144 formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve të propozuar nga 12 subjekte zgjedhore, rezultoi se E. B., kandidat i subjektit zgjedhor LSI ka referuar në formularin e tij që është shoqëruar në protestën për mbrojtjen e teatrit më datë 17.05.2020 dhe në protesta të tjera të opozitës.

⁸ <https://ëëë.zeriamerikes.com/a/xhelal-mziu-arrest/1814639.html>
<https://tvklan.al/gjykata-e-apelit-shpall-te-pafajshem-kryebashkiakun-e-kamzes-xhelal-mziu>
<https://euronews.al/al/vendi/politike/2021/03/26/kqz-con-per-verifikim-te-thelluar-28-kandidate-per-deputete/>

e) Përsa i përket **Qarkut Berat**, u konstatua se vetëm 2 kandidatë kanë reflektuar në formularët e tyre të vetë-deklarimit, veprimet e ndalimit/shoqërimit apo arrestimit nga ana e policisë/prokurorisë. Veprat penale të cilat shërbejnë si referencë e këtyre vendimmarrjeve nuk rezultojnë të përfshihen në spektrin e ndalimeve të kandidimit sipas ligjit nr. 138/2015.



Lidhur me këtë qark, rezultojnë se 12 subjekte zgjedhore kanë propozuar nga 9 kandidatë secili, duke e çuar numrin e kandidatëve në 108. Formularët e dekriminalizimit të tyre u monitoruan nga KShH dhe rezultuan këto gjetje, në vijimësi.

Për subjektin zgjedhor PS, rezultojnë se B.K. ka deklaruar se ka qenë i arrestuar në vitin 1994, por me Vendimin e gjykatës nr.819 dt. 11.10.1994, është vendosur pushimi i çështjes. Gjithashtu, kandidati K.Q. citon të jetë dënuar me gjobë për kundërvajtje penale me vendimin Nr. 70, datë 24.03.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për veprën e kanosjes. Kjo dispozitë nuk përfshihet në veprat që ndalojnë kandidimin sipas ligjit Nr. 138/2015.

KShH vëren se gjatë këtij procesi zgjedhor, legjislacioni i posaçëm mbi dekriminalizimin ka pasur efekte edhe tek kandidatët e subjekteve zgjedhore të krijuara rishtazi apo partive të vogla. P.sh: në rastin e rreth 5 kandidatëve, propozime të partive të vogla në garë rezultojnë se Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar nga ana e autoriteteve policore të huaja ose Ministrive të Drejtësisë homologe, informacion shtesë mbi veprat penale të pasqyruara nga vetë kandidatët në formularët e vetë-deklarimit ose mbi bazën e indicieve të përcjella nga KQZ.


Konkretisht, sa i përket subjektit zgjedhor ABEOK, sipas të dhënave të bëra publike nga KQZ në muajin Mars, kandidatja E.V. rezultojnë të jetë në listen e kandidatëve për të cilët KQZ i ka kërkuar hetim të thelluar Prokurorisë.⁹ Kjo kandidatë ka plotësuar në formularin e vetëdeklarimit se për të është marrë masa e dëbimit nga shteti Gjerman. Gjithashtu, dhe kandidati E.A. (i subjektit Balli Kombëtar) ka vetëdeklaruar në formularin e tij se ka qenë i ndaluar si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të kundërshtimit të punonjësit të policisë, por në vitin 2006 kjo masë shtrënguese është zëvendësuar me atë të detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Në Nëntor të vitit 2006, është marrë vendimi për pushimin e akuzës ndaj këtij kandidati. Lidhur me subjektin zgjedhor LSI, kandidati I.O. ka deklaruar se në vitin 1991 është përjashtuar nga dënimi. Në një periudhë të mëvonshme, ai është proceduar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kundërshtimin e punonjësit të policisë së rendit publik. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, me vendimin nr. 380, datë 17.02.2020, e ka pushuar çështjen në ngarkim të tij, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet si vepër penale me ligj.

Sa më sipër, konstatohet se roli i publikut në ofrimin e kontributit nëpërmjet vënies në lëvizje të organeve kompetente për procesin e dekriminalizimit mbetet i vakët. Edhe pse konstatohet se institucionet përgjegjëse kanë vepruar me ritme të shpejta, nisur dhe nga vetë shqetësimet e ngritura nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme në raport me autoritetet homologe në vendet fqinje,

<https://euronews.al/al/vendi/politike/2021/03/26/kqz-con-per-verifikim-te-thelluar-28-kandidate-per-deputete/>
<https://top-channel.tv/2021/03/26/zgjerohet-lista-e-kandidateve-per-deputete-qe-do-kalojne-ne-siten-e-drejtises-emrat9/>

KShH vlerëson se afati 3 mujor më të drejtë zgjatjeje që i është njohur këtij institucioni për realizimin e verifikimeve të thelluara është i ngushtë dhe jo i arsyeshëm. Duke qenë se fokusi i miratimit të këtij ligji mbetet moslejimi për të kandiduar i shtetasve me problematika në kontekstin e integritetit, në rast se procedura e verifikimit e bazuar në përgjigjet e letërporosive të shkëmbyera me autoritetet e huaja reflekton të dhëna ndaluese, pasi kandidatit i është akorduar mandati, zbatimi i ligjit do e humbiste rolin e tij parandalues.

Dinamika e procesit zgjedhor dhe volumi i dokumentacionit që kërkohet të verifikohet për secilin kandidat, brenda një periudhe kaq të shkurtër kohore vlerësojmë se mund të ishte shmangur në rast se subjektet zgjedhore të regjistruara do të kishin depozituar kërkesa për verifikim paraprak pranë Prokurorisë së Përgjithshme për kandidatët e tyre potencial.¹⁰ Gjithashtu, nisur nga të dhënat e përcjella nga vetë Prokuroria e Përgjithshme rezulton se Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe ato të Apelit në vendin tonë e realizojnë procedurën e verifikimit manualisht, pasi nuk disponohet një sistem elektronik i administrimit të të dhënave të çështjeve/procedimeve penale, si rrjedhojë bashkërendimi institucional ndërmjet këtyre institucioneve, Policisë së Shtetit etj., me Prokurorinë e Përgjithshme realizohet në rrugë zyrtare.



Në një analizë krahasimore me procesin për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në vitin 2017, referuar Raportit të publikuar nga KQZ rezulton se nga verifikimi i dokumentacionit për 2723 kandidatë, 57 prej tyre (ose rreth 2% e totalit) kishin dënime me burgim me vendim të formës së prerë. Gjithashtu, vërehet se 2666 kandidatë nuk kishin të deklaruar asnjë të dhënë që përfshihet në kushtet e nenit 2, pika 1 dhe 2 të ligjit 138/2017, për ndalimin e kandidimit. Vetëm për 2 deputetë rezulton se Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar verifikim të thelluar nga ana e KQZ. Ndërkohë që pas verifikimit nga Prokuroria e Përgjithshme rezulton se këta kandidatë nuk kanë pasqyruar në formularët e vetë-deklarimit të dhënat ndaluese, duke cënuar në këtë mënyrë legjislacionin në fuqi.

Duke qenë se ende nuk është shpallur rezultati përfundimtar i zgjedhjeve, KQZ nuk rezulton të ketë publikuar raport mbi zbatimin e legjislacionit të dekriminalizimit për Zgjedhjet Parlamentare të dt. 25 Prill 2021. Nisur nga të dhënat paraprake, rezulton se KQZ ka kërkuar verifikimin e plotë

¹⁰ Pika 1 vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.



nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme për 30 kandidatë, një numër ky më i lartë kandidatësh në raport me zgjedhjet parlamentare të vitit 2017. Deri në këto momente, duke qenë se procedura e verifikimit të thelluar rezulton të ketë përfunduar vetëm për 4 subjekte, për asnjë prej tyre nuk konstatohet që të jetë konstatuar cënim i dispozitave të ligjit 138/2015. Ky rezultat i deritanishëm paraqitet pozitiv në raport me atë të vitit 2017, element i cili reflekton kujdes më të lartë të subjekteve kandiduese dhe informim mbi zbatimin e legjislacionit për dekriminalizimin. Gjiths, KShH mendon se këto të dhëna paraprake mbeten për t'u vlerësuar në momentin e përmbylljes së procesit të verifikimit nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme dhe vendimmarrjeve respektive për aprovimin e rezultateve të verifikimit nga ana e KQZ për pjesën tjetër të kandidatëve, për të cilët procesi vijon ende.

Në përfundim të këtij procesi monitorimi:

- 1. Referuar garantimit të integritetit të kandidatëve, në kushtet e zbatimit të legjislacionit të posaçëm për dekriminalizimin, iu rekomandojmë subjekteve zgjedhore, me pëlqimin e mundshëm të kandidatëve pjesë e listave shumëemërore, jashtë periudhës zgjedhore ose menjëherë pas regjistrimit të tyre në KQZ, të kërkojnë verifikimin e thelluar nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme.**
- 2. KShH rekomandon realizimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor lidhur me afatet e regjistrimit të partive politike si subjekt zgjedhor dhe paraqitjen e listave shumë emërore (nenet 65 dhe 67 KZ). Kjo me qëllim për të mundësuar krijimin e afateve më të arsyeshme që i mundësojnë Prokurorisë së Përgjithshme verifikimin e formularëve që i dërgohen nga KQZ-ja.**